

# MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

midis

SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR

DHE

FAKULTETIT TË GJEOLGJISË DHE MINIERAVE

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) i përfaqësuar në nënshkrimin e këtij Memorandumi nga Dr. Viktor Doda, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar

dhe

Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave i përfaqësuar në nënshkrimin e këtij Memorandumi nga Prof. Dr. Përparim Hoxha, Dekan i Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave,

këndeje e tutje të referuar në formë individuale si "Pala", apo në formë kolektive si "Palët" evidentojnë aspekte pozitive të bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor, të projekteve në zgjidhje të problemeve me rëndësi kombëtare (si psh, ndërtimi i hartave gjeologjike, hidrogeologjike, tektonike etj, në shkallë 1:200 000), realizimi i evenimente të përbashkëta shkencore (kongrese, konferenca, workshop-e, seminare) kombëtare dhe ndërkombëtare.

## Parathënie

Duke marrë parasysh vlerat komplementare në infrastrukturë, kompetenca, njohuri dhe më specifikisht,

- Në lidhje me projektet kërkimore kombëtare e ndërkombëtare
- Për botimin e Buletinit të Shkencave Gjeologjike
- Për shfrytëzimin reciprok të aseteve laboratorike
- Për mbështetjen reciproke në kërkimin shkencor dhe procesin e mësimdhënies
- Për organizimin e evenimenteve të përbashkëta shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
- Për shkëmbimin e përvojave dhe të njohurive

Palët pranojnë të bashkëpunojnë në fushat vijuese të interesit të përbashkët.

## Subjekti dhe qëllimi i bashkëpunimit

1. Botimi i përbashket i Buletinit të Shkencave Gjeologjike, i drejtuar nga një Redaksi në përbërjen e të cilës do të ketë personalitete shkencore nga të tre Institucionet e Gjeologjisë, SHGJSH, FGJM dhe IGJEUM.
2. Organizimi i evenimenteve të përbashkëta shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
3. Shkëmbim të njohurive shkencore dhe eksperiencave konkrete për ngritjen e nivelit të punës kërkimore dhe procesit mësimor.
4. Ndërmarrja e projekteve të përbashkëta me rëndësi kombëtare dhe e projekteve në kuadrin e programeve kërkimore të BE.
5. Mbështetja reciproke për diplomantet, specialistet dhe doktorantet duke vënë në dispozicion asete, infrastrukturë dhe kapacitete njerëzore.
6. Angazhimin e stafëve të përbashkëta për të propozuar strategji të zhvillimit të gjeologjisë, në edukim dhe kërkim, në mbështetje të programeve afatgjata të vendit, me qëllim hapjen e fronteve të reja të punës për brezat e rinj të specialisteve.

## MODALITETET E BASHKËPUNIMIT

Palët do ta përqëndrojnë bashkëpunimin e tyre në shkëmbimin e informacionit dhe publikimeve, aplikimin dhe përmirësimin e metodave laboratorike dhe të kërkimit, punime të përbashkëta fushore, bashkëpunim në projekte me interes të dyanshëm, organizimin e takimeve dhe publikimeve të përbashkëta të rezultateve shkencore dhe teknike të projekteve të bashkëpunimit.

Palët bien dakord që rezultatet e kërkimeve, i gjithë informacioni i rëndësishëm dhe njohuritë e fituara prej projekteve të përbashkëta do të shpërndahen e publikohen ose do të mbahen konfidenciale në përputhje me termat specifike të caktuara nga të dyja Palët për projekte të veçanta. Kjo mënyrë veprimi dhe mbrojtja e pronësisë intelektuale duhet të jetë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Palët bien dakord të marrin pjesë në projekte ndërkombëtare dhe më specifikisht në Programin Kuadër 7 të BE (7<sup>th</sup> EU Framework Program), Horizon 2020, etj.

## KOSTOT

Aktivitetet kërkimore (projekte, evenimente, botime) do të mbahen në përputhje me ligjet dhe rregulloret e vendit dhe secila Palë duhet të mbulojë shpenzimet e veta (si p.sh. kostot e paisjeve dhe personelit, shpenzimet e udhëtimeve, akomodimin, siguracionet) gjatë kryerjes së tyre. Aktivitetet e bashkëpunimit do të varen nga mundësitë e financimit të secilës Palë. Termat e financimit, kur të jetë e domosdoshme, duhen vendosur nga Palët përpara fillimit të projekteve individuale.

## HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE NDËRPREJA

Ky Memorandum hyn në fuqi sapo të nënshkruhet nga të dyja Palët dhe mbetet në fuqi për 5 (pesë) vjet. Ai mund të amendohet apo zgjerohet nëpërmjet një marrëveshje të

përbashkët me shkrim të Palëve. Ai mund të ndërpritet në çdo kohë nga cilado Palë, 6 muaj pas njoftimit me shkrim bërë Palës tjetër. Ndërprerja e tij nuk do të prekë vlefshmërinë e kohëzgjatjes së projekteve që kanë filluar nën këtë Memorandum më përpara se ajo të ndërpritej.

Ky Memorandum është i shkruar në gjuhën Shqipe dhe është nënshkruar në katër kopje në Tiranë.

Tiranë, më 10/09/2014

Dr. Viktor DODA  
  
Drejtör i Përgjithshëm  


Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Prof. Dr. Përparim Hoxha  
  
Dëkan  


Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave